



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 475/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: -Kimete Gashi-Kryetare, Vjosa Gradinaj Mexhuani-Referuese dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "Quality Asphalt SHPK" lidhur me aktivitetin e prokurimit „Rikonstruimi i rrugëve në Ribar të Madh (rr. Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi)" me nr. të prokurimit 613-22-7288-5-2-1, iniciuar nga Komuna e Lipjanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 30.11.2022, mori:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar, ankesa e operatorit ekonomik "Quality Asphalt SHPK" e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 21.09.2022, Numër protokolli 475/2022, për aktivitetin e prokurimit „Rikonstruimi i rrugëve në Ribar të Madh (rr. Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi)" me numër të prokurimit 613-22-7288-5-2-1, kurse Vendimi i AK, për dhënien e kontratës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Vertetohet.

Konfiskohet shuma e mjeteve të deponuar në emrin e tarifës për ankesë dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konform nenit 31 par 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.07.2022, Komuna e Lipjanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit „Rikonstruimi i rrugëve në Ribar të Madh (rr. Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi)" me numër të prokurimit 613-22-7288-5-2-1. Kurse me 02.09.2022, AK (me shënime si më sipër), ka publikuar Vendimin për dhënie të kontratës, për operatorin ekonomik të rekomanduar OE „Bujar Shabani B.I & AVAG GROUP" SHPK.

Me 21.09.2022, kundër vendimit të cituar si më sipër të autoritetit kontraktues, operatori ekonomik "Quality Asphalt SHPK" nga cilësia e tij si palë e pakënaqur, ka ushtruar ankesë në OSHP.

Me 21.09.2022, kundër vendimit të cituar si më sipër të autoritetit kontraktues, operatori ekonomik "Quality Asphalt SHPK" nga cilësia e tij si palë e pakënaqur, ka ushtruar ankesë në OSHP.

Ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 dhe 114, të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 28.09.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pa bazuar;
- Të mbetet në fuqi Vendimi i AK për dhënie të kontratës, i datës 02.09.2022;

Duke vepruar mbi bazën e parimeve përgjithshme të parapara me nenet 6 dhe 7 dhe parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të Ligjit të cituar dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, konstatohet se:

- Përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit, me kriteret si në vijim: lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës 230.000,00 €;
- Kurse, pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, konsistojnë në atë se OE ka dorëzuar dokumente të falsifikuara dhe dokumente në kundërshtim me nenin 13 të LPP;

Ankuesi në ankesën e parashtruar kundër Njoftimit të AK për dhënien e kontratës, ka pohuar mes tjerash se OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm sipas kriterëve të kërkuara, për arsyet, theksuar shkurtimisht si në vijim: a) dyshohet në falsifikimin e kontratës së inxhinierit; b) bashkë me marrëveshjen e bashkangjitur për pajisjen Cilindër HAMM HD 14 TT, me peshë 3,5 Ton, të nënshkruar mes OE „Bujar Shabani B.I & AVAG GROUP SHPK" dhe IZOLACIJA, me seli në Shkup, e ka dorëzuar faturën në gjuhën maqedonase, e cila bije në kundërshtim me paragrafin 4, të nenit 13 të LPP;

Paneli shqyrtues gjatë shikimit dhe analizimit të shkresave të kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës e duke u bazuar në nenin 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP lidhur me çështjen në rastin konkret, ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesa në këtë rast. Andaj duke i analizuar pretendimet e ankuesit, përmbajtjen e tyre dhe raportin e ekspertit shqyrtues Paneli Shqyrtues konsideron se:

1. OSHP konsideron se AK ka kompetenca, kapacitet profesional dhe organizativ për ta analizuar në mënyrën e drejtë dhe të duhur faktin, nëse kontrata e inxhinierit në këtë rast është dokument i faksifikuar apo jo. OE i rekomanduar ka prezantuar listën e stafit profesional në të cilën figuron edhe Inxhinieri i Gjeodezisë duke e prezantuar Kontratën dhe Licencën e punës nr.129, të datës 15.02.2019 me afat deri 13.02.2024, e lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

2. Kurse, fatura (në gjuhën maqedonase) është dokument me natyrë sekondare në raport me marrëveshjen e bashkëngjitur, sepse marrëveshja e cituar përbën bazën juridike të raporteve kontraktuese, jo fatura. Kontrata në parim dhe efektet e saja rregullohen me parimet e përgjithshme të Ligjit mbi marrëdhëniet detyimore kurse në mënyrë specifike dhe me Ligjin për prokurimin publik. Së këndejmi, ankesa e parashtruar edhe nga ky aspekt është e pa bazuar, sepse pretendimet e ankuesit nga ky aspekt nuk përkojnë me paragrafin 4, të nenit 13 të LPP sipas të cilit, cituar: “Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose gjuhën Angleze”. Shprehja *tender* në kuptimin e paragrafit të cituar nuk konsiston në faturën, si akt i veçuar, por nënkupton gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga një OE, me ç’rast AK ka respektuar specifikat e dosjes së tenderit.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara si më sipër, Paneli konsideron se rekomandimet e ekspertit shqyrtues janë të pranueshme dhe të bazuara në analiza dhe shpjegime profesionale. Kurse AK ka krijuar bindjen reale dhe gjykimin e pavarur se dokumentacioni dhe oferta e OE të rekomanduar i përgjigjet planifikimit të prokurimit në kuptim të nenit 8, dhe përcaktimit të nevojave që duhen përmbushur sikurse parashihet me nenin 9, të Ligjit për prokurimin publik.

Sikurse pohon edhe eksperti shqyrtues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit AK ka zhvilluar procedurë të hapur në të cilin janë paraqitur gjithsejtë 4/katër entitete afariste konkurrencte nga të cilët AK ka pasur të drejtë që ta rekomandoj OE “Bujar Shabani BI & AVAG GROUP SHPLK, si entitet të përgjegjshëm dhe me çmimin më të lirë, duke vepruar kështu në harmoni me nenin 61, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

- Përfundim -

Bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara si më sipër dhe provat e administruara, Paneli shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në harmoni me kriterin e dosjes së tenderit oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë, andaj paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarija e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj - Mexhuani



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;

1x1 AK – Kuvendi Komunal Lipjan

1x1 OE- “Bageri Bujar Shabani B.I.& AVAG Group ShPK” sh.p.k. seli në Ferizaj

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së